

KLSH merr pjesë në Programin pilot të Akademisë Ndërkombëtare të OECD për Hetimin e Tatimeve dhe Krimin Financiar me temë “Keqpërdorimi i teknologjisë në krimet financiare”

Ostia, 31 mars - 4 prill 2025



U zhvillua në Ostia nga data 31 mars - 4 prill 2025, Programi pilot i Akademisë Ndërkombëtare të OECD-së me temë “Keqpërdorimi i Teknologjisë në Krimet Financiare”. KLSH mori pjesë për herë të parë në këtë program me znj. Joniada Goçaj.

Ky program kishte në fokus çështjet lidhur me:

- Si përdorimi i teknologjisë shfrytëzohet për të lehtësuar evazionin fiskal, pastrimin e parave dhe krime të tjera financiare;
- Sa thelbësor është kuptimi i këtyre rreziqeve me qëllim forcimin e kapaciteteve hetimore dhe zbatimin e ligjit, mbrojtjen e financave publike dhe sigurimin e integritetit të sistemit financiar global.

Disa nga temat kryesore që u trajtuan gjatë këtij programi ishin:

- “Big Data” në Krimet Financiare: Kuptimi i rolit të tyre në identifikimin dhe parandalimin e krimeve financiare;
- Keqpërdorimi i Teknologjisë Financiare (FinTech) dhe Krimet e Reja: Si keqpërdoren teknologjitë financiare për aktivitete të paligjshme;
- Inteligjenca Artificiale dhe ChatGPT: Roli i inteligjencës artificiale në lehtësimin dhe luftimin e krimeve financiare;
- Crypto Assets and Blockchain: Analizimi i rreziqeve që lidhen me kriptovalutat, financën e decentralizuar dhe NFT-të. ("Të Pasurive Dixhitale Jo të Këmbyeshme");
- Rreziqet e Pastrimit të Parave nga Keqpërdorimi i Kriptovalutave: Identifikimi i vulnerabiliteteve dhe zbatimi i masave efektive kundër tyre;

Gjatë programit pesë ditor u trajtuan shembuj konkretë nga vendet si: Holanda; Britania e Madhe, Hong Kongu dhe Singapore, në lidhje me keqpërdorimin e teknologjisë në krimet financiare.

Në përfundim të programit u theksua se megjithëse teknologjia ofron përfitime të mëdha në luftën kundër krimeve financiare, ajo gjithashtu krijon mundësi për krime të sofistikuara, përfshirë:

- ✓ Shmangjen e tatimeve duke përdorur platformat e financës të decentralizuara;
- ✓ Pastrimin e parave përmes NFT-ve dhe shkëmbimeve të kriptovalutave;
- ✓ Keqpërdorimin e inovacioneve nga Inteligjenca Artificiale dhe Fintech që mund të përdoret për të fshehur aktivitete të paligjshme si pastrimi i parave, duke përdorur platformat e financës së decentralizuar ose kriptovalutat, për fitime të paligjshme.